

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ekspozita “Liri në hapësirë”: Kur arti del nga korniza
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/ekspozita-liri-ne-hapesire-kur-arti-del-nga-korniza-i-586167
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:07:05 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 12:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8604c677caafc53c38c1280ea8a78c9820828903267c57ee85109c045142209b
TEKSTI	f71496744582ff6c8924d6308cd8aeb3b0d913f656514e347fb7ca9c6f789236
PAMJA	23105155c2cf023d75ddef4adc2aa5c300219b06a068f27d0885e08c0630370c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f926d797859ff3794669c5a48628a010c0a676303206df7a3de0cd07ce50a648
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f926d797859ff3794669c5a48628a010c0a676303206df7a3de0cd07ce50a648>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



le Rama publikon pamjet nga rruga e Komanit: Transformim mes peizazhit spektakolar te veriutSi vendos familja mbretërore britanike per shkolimin e femijeve? William fundit

Ekspozita “Liri në hapësirë”: Kur arti del nga korniza

TemA

15 Shtator 2026, 14:01Kulturë TEMA



Sa e lirë mund të jetë vepra përballë kufirit? Blerina Bezo sjell pikturën, grafikën dhe skulpturën në dialog me natyrën, dritën, muzikën dhe publikun. “Liri në hapësirë” është edhe një refleksion mbi rolin e artistit. Artisti nuk krijon jashtë realitetit, por brenda tij, duke kërkuar vazhdimisht hapësira të reja për ta transformuar.

Piktura del nga muri. Skulptura nuk qëndron mbi një piedestal të izoluar. Grafika nuk shihet vetëm si sipërfaqe e kornizuar. Ato vendosen në një territor ku ambienti ndërhyr vazhdimisht mbi to. Drita ndryshon tonalitetet. Hijet krijojnë kompozime të përkohshme. Degët, bari dhe strukturat e drurit hyjnë në dialog me linjën, ngjyrën dhe materialin. Muzika krijon një tjetër shtresë perceptimi.

Nga kjo ide lindi ekspozita “Liri në hapësirë”, e piktores dhe skulptores Blerina Bezo e çelur më 2 shtator 2026, në kuadër të edicionit të shtatë të “Festës së Këngës Shqiptare” në mjediset e Flumen Park, në fshatin Ibë të Tiranës.

Një mbrëmje ku muzika dhe arti pamor nuk u paraqitën si dy realitete të ndara. Pikturat, grafikët dhe skulpturat u vendosën në hapësirën e gjelbër, mes pemëve dhe dritës së mbrëmjes, duke krijuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me ambientin dhe me publikun.

Titulli “Liri në hapësirë” lidhet me një pyetje që e ka shoqëruar vazhdimisht mendimin artistik: sa e lirë mund të jetë vepra përballë kufirit?

“Në mendimin e Sigmund Freud-it, liria individuale shfaqet gjithmonë në një marrëdhënie tensioni me rendin që e rrethon njeriu. Qytetërimi krijon strukturë dhe siguri, por në të njëjtën kohë kërkon kufizimin e impulseve individuale. Për Freud-in, dëshira për liri mbetet një forcë e vazhdueshme që përballlet me kërkesat e bashkësisë”- shprehet artistja, ndërsa shton se tensionin në këtë ekspozitë e ka kërkuar jo përmes ilustrimit të drejtpërdrejtë të një teorie, por përmes marrëdhënies së veprës me hapësirën.

Kështu, hapësira nuk është më sfond. Ajo bëhet një element aktiv i veprës.

Në punimet grafike, figura njerëzore mbetet e lidhur me një gjuhë më të përmbytur, ku vija dhe kontrasti ndërtojnë tensionin psikologjik. Përballë tyre, pikturat abstrakte çlirojnë sipërfaqen përmes ngjyrës, gjurmës dhe materialitetit. Ndërsa skulpturat, të vendosura drejtpërdrejt pranë trungut të pemës, krijojnë një raport tjetër: atë mes materies së përpunuar nga njeriu dhe formës organike të natyrës.

Ky ndryshim i gjuhëve pamore nuk është rastësor.

“Për mua, liria nuk do të thotë mungesë strukture. Përkundrazi, ajo bëhet e dukshme pikërisht kur struktura ekziston dhe artisti negocion me të. Vija ka kufijtë e vet. Telajo ka dimensionet e saj. Materia ka rezistencën e saj. Hapësira ka arkitekturën e saj”, - zbulon Bezo, e cila është njëherësh pedagoge në Universitetin Europian të Tiranës dhe studiuese fushën e Arteve Pamore dhe Skenike.

Studimet e saj kërkimore zbulojnë shtresëzimet historike të skenografisë, ndërthurjen e traditës me gjuhën bashkëkohore dhe mënyrën se si arti formëson ndjeshmërinë estetike të brezave të rinj.

Për artisten, krijimi fillon pikërisht në momentin kur këto kufij nuk pranohen si përfundimtarë.

Në këtë kuptim, “Liri në hapësirë” është edhe një reflektim mbi rolin e artistit. Artisti nuk krijon jashtë realitetit, por brenda tij, duke kërkuar vazhdimisht hapësira të reja për ta transformuar.

“Vendosja e ekspozitës në natyrë më lejoi të hiqja një nga kufijtë më tradicionalë të ekspozimit: distancën midis veprës dhe publikut. Vizitori nuk hynte në një sallë për të parë artin. Ai ecte mes veprave. I afrohej një pikturë, largohej prej saj, kalonte pranë një skulpturë ndërsa dëgjonte muzikën. Përjetimi nuk kishte një itinerar të detyruar. Në këtë mënyrë, edhe publiku fitonte lirinë e vet. Jo lirinë për të “kuptuar saktë” veprën, por lirinë për ta përjetuar atë”, shton. Blegina Bezo i përket asaj kategorie krijuesish të cilët mendojnë se një vepër arti nuk duhet të mbyllet plotësisht në shpjegimin e autorit. Ajo duhet të lërë një hapësirë ku shikuesi mund të hyjë me kujtesën, përvojën dhe ndjeshmërinë e tij.

Prandaj “Liri në hapësirë” nuk është vetëm titulli i një ekspozite. Është një mënyrë për ta menduar marrëdhënien mes veprës, artistit dhe botës. Liria nuk është zbrazëti, por një hapësirë e fituar mes kufijve. Dhe ndoshta arti fillon pikërisht aty. /MAPO/

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ambasadorja e Kinës në Shqipëri, Pang Chunxue, vizitoi Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit](#)

08:52 Kulturë

[Jonid Jorgji përplasët me Mevlan Shanajn: Ke marrë fonde dhe nuk ke bërë asgjë, kthe lekët...](#)

20:21 Kulturë / 5 komente

Historia e kokës së prerë të Ali Pashës te Sulltani! Si përfundoi PIKTURA që flakën komunistët dhe e blenë grekët te holli i Porto Palermos

16:49 Kulturë / 2 komente



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.